



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit



LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

MUAJI MARS 2026

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për caktimin e komisionit për pranim të shërbimeve.	NRP-02-7044-2026
2.	Vendim për caktimin e komisionit për pranim të shërbimeve.	NRP-02-7045-2026
3.	Vendim për shfuqizimin e vendimit, vendosja e trafos elektrike në lagjen "Vëllezërit Frashëri" në Rahovec.	NRP-02-7046-2026
4.	Vendim për rikonstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve.	NRP-02-7047-2026
5.	Vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e hapësirave (zyrave) në disa vendbanime.	NRP-02-7054-2026
6.	Vendim për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive.	NRP-02-7059-2026
7.	Vendim për shfuqizimin e vendimit 6769 të datës 15.12.2025.	NRP-02-7060-2026
8.	Vendim për lirim të pagesave të taksës komunale.	NRP-02-7061-2026
9.	Vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit disiplinor	NRP-02-7064-2026
10.	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza.	NRP-02-7071-2026
11.	Vendim për autorizimin për punë shtesë - jashtë orarit të punës.	NRP-02-7072-2026
12.	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për tërheqjen e petty cash-it.	NRP-02-7073-2026
13.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie të subvencioneve për ndihma financiare për vitin 20206.	NRP-02-7080-2026
14.	Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare.	NRP-02-7084-2026
15.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e veturave jashtë përdorimit.	NRP-02-7085-2026
16.	Vendim për përfundimin e marrdhënies së punës.	NRP-02-7087-2026
17.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shërbimeve të udhëtimit.	NRP-02-7089-2026
18.	Vendim për formimin e Ekipit për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Vecanta Arsimore.	NRP-02-7095-2026
19.	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Lokal në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-7096-2026

20.	Vendim për vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes publike "Përkrahja e fermerëve me pleh artificialë".	NRP-02-7097-2026
21.	Vendim për caktimin e komisionit për falsifikimin dhe ndarjen e poceve elektrike dhe të mbajtësve.	NRP-02-7101-2026
22.	Vendim për themelimin e komisionit komunal për kthim në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-7102-2026
23.	Vendim për ndër prerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve.	NRP-02-7103-2026
24.	Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes publike për aplikim.	NRP-02-7104-2026
25.	Vendim për formimin e komisionit për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e pronave për caktimin e vendit të deponisë vetëm për mbeturina të dheut dhe të betonit.	NRP-02-7108-2026
26.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të projekteve sipas thirrjes publike në fushën e artit, kulturës dhe Sportit.	NRP-02-7113-2026
27.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në thirrjen publike për klubet sportive dhe OJQ-të rinore për vitin 2026.	NRP-02-7114-2026
28.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në thirrjen publike në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore për vitin 2026.	NRP-02-7115-2026
29.	Vendim për caktimin e komisionit për regjistrimin e veturave që janë jashtë përdorimit në institucionin e Komunës së Rahovecit.	NRP-02-7121-2026
30.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : "Servisimi dhe mbushja e aparateve zjarrfikëse"	NRP-02-7123-2026
31.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit.	NRP-02-7124-2026
32.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit.	NRP-02-7125-2026
33.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : "Furnizimi me pajisje me inventarë të shkollave"	NRP-02-7129-2026
34.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : "Furnizimi me vaksina për bagëti"	NRP-02-7131-2026
35.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : "Furnizimi me pajisje të Teknologjisë Informativ (laptopë) për anëtarët e Kuvendit Komunal"	NRP-02-7134-2026
36.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : "Konkurs projektimi për dizajnimin e logos dhe brendimin e turizmit"	NRP-02-7137-2026
37.	Vendim për shfuqizimin e urdhëresës për shpalljen e tenderit: "Furnizimi i bagëtive me vaksina"	NRP-02-7138-2026
38.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : "Furnizimi me vaksina për bagëti"	NRP-02-7143-2026
39.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe turizëm"	NRP-02-7146-2026

40.	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin e Komitetit Komunal Veprues.	NRP-02-7147-2026
41.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : “Digjitalizimi i shkollave me paisje moderne,laboratorë të pajisur me teknologji të reja”	NRP-02-7149-2026
42.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : “Furnizimi me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit”	NRP-02-7151-2026

Mars, 2026

Rahovec



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/ABINETI PRESIDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7044 Nr. i faq/Br.str/No.pg 07
Data/Datum/Date 02 / 03 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008),nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L – 042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L- 068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Prokurimit Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për pranim të shërbimeve

1. **Caktohet** komisioni për pranimin e shërbimeve të kryera sipas kontratës me titull: “**Mirëmbajtja e objekteve të komunës - LOT 1**” me nr. të kontratës: 623-25-6580–2–1–1/C 700, në këtë përbërje:
 - 1.1. Qamil Sylka, kryesues,
 - 1.2. Izet Morina, anëtar,
 - 1.3. Petrit Haxhijaha, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin e shërbimeve të kryera sipas kontratës me titull: “**Mirëmbajtja e objekteve të komunës - LOT 1**” me nr. të kontratës: 623-25-6580-2-1-1/C 700.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Administratë.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Administratë,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7045 Nr. i faq./Br.str/No.pg 07

Data/Datum/Date 02 03 / 26

RAHOVEÇ / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008),nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L – 042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L- 068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Prokurimit Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për pranim të shërbimeve

1. Caktohet komisioni për pranimin e shërbimeve të kryera sipas kontratës me titull: **“Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore – LOT 2”** me nr. të kontratës: 623-25-6580–2–1–1/C 701, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ahmet Latifi, kryesues,
 - 1.2. Valmire Gashi - Popaj, anëtare,
 - 1.3. Avdi Kastrati, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin e shërbimeve të kryera sipas kontratës me titull: **“Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore - LOT 2 ”** me nr. të kontratës: 623–25–6580–2–1–1/C 701.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDHKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7046 Nr. i faq./Br.str./No.pg 07

Data/Datum/Date 02.03.26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44, nenit 49 dhe nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/2016”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:


V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET** vendimi me nr. prot. 02/4638, i datës 20.8.2024, me të cilin është bërë shpronësimi i pronës së paluajtshme për interes publik, për vendosjen e trafos elektrike në lagjen “Vëllezërit Frashëri” në Rahovec.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

Me vendim të njoftohen:

- *Pronari i parcelës kadastrale,*
- *Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"),nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-84 për Mbrojtjen e Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14/2019), në zbatim të nenit 6 lidhur me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionalizimin e ekipit për të drejtat e fëmijëve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për rikonstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve

1. Miratohet vendimi për rikonstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve për zbatimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Smajl Latifi, kryesues - Kryetar i Komunës,
 - 1.2. Afrim Oruqi, zëvendëskryesues - Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
 - 1.3. Muhamet Morina, anëtar – Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
 - 1.4. Atdhe Rama, anëtar – Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
 - 1.5. Afrim Limani, anëtar - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
 - 1.6. Fatmir Iska, anëtar – Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës,
 - 1.7. Genta Morina, anëtare - Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës,
 - 1.8. Habibe Haxhimustafa, anëtare - Zyrtare për Mbrojtjen e Fëmijëve - Njësia për të Drejtat e Njeriut,
 - 1.9. Qëndrim Kryeziu, anëtar – Përfaqësues i Policisë,
 - 1.10. Hyrmete Topalli, anëtare - Përfaqësuese e Qendrës për Punë Sociale,
 - 1.11. Adea Lubovci, anëtare– Sh.P.G "Hareja".
2. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe këshilltarë të jashtëm janë:
 - 2.1. Ea Çanta - Përfaqësuese e fëmijëve,
 - 2.2. Fidan Shala - Përfaqësues i Këshillit të Prindërve,
 - 2.3. Mark Kaqinari - Përfaqësues i Avokatit të Popullit,
 - 2.4. Sead Raba - Përfaqësues i OSBE-së,
 - 2.5. Lahuta Dula - Përfaqësuese e SHL Kosova.
3. Sekretariat i ekipit caktohet zyrtari /ja për mbrojtje të fëmijëve - Njësia për të Drejtat e Njeriut, në Komunën e Rahovecit, mbështetur nga Kabineti i Kryetarit, për të koordinuar, për të monitoruar dhe për të zhvilluar aktivitetet e nevojshme për punën e ekipit.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit përcaktohen sipas Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të ekipit, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Orahovac
Opština Orahovac / Municipality Orahovac

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Dr./No 7054 Nr. i faq./Br.str./No.pg 08

Data/Datum/Date 02.03.26

ORAHOVAC / GRAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr.1005 i dt. 29.03.2017, kërkesës së Stacionit Policor në Orahovec me nr. refer. 05/3-07R-103/26, të datës 26.2.2026, kërkesës së fshatit Hoçë e Vogël me nr. prot. 963, të datës 24.2.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Formohet komisioni për përzgjedhjen e hapësirave (zyrave) në disa vendbanime

1. Caktohet komisioni në këtë përbërje:
 - 1.1. Petrit Haxhijaha, kryesues,
 - 1.2. Artan Asllani, anëtar,
 - 1.3. Albina Durguti, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e hapësirave në disa vendbanime: në Krushë të Madhe, në Ratkoc dhe në Hoçë të Vogël.
3. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë e Administratës.
4. Komisioni do të fillojë punët menjëherë dhe duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Administratë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 12, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr.01. Nr.109, të datës 14.07.2006

1. Caktohet grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr.01. Nr.109 të dates 14.07.2006, në këtë përbërje:
 - 1.1 Jetmir Ukaj - zyrtar teknik i ndërtimtarisë, kryesues
 - 1.2 Mirsad Shala - zyrtar ligjor, anëtar
 - 1.3 Diellza Çanta - zyrtare e lartë për leje ndërtimore, anëtare
 - 1.4 Biondina Rama - zyrtare e lartë për mbrojtje të mjedisit, anëtare
 - 1.5 Sylejman Daka – inxhinier i ndërtimtarisë, anëtar
 - 1.6 Hasan Eminazeri- inspektor i komunikacionit dhe ndërtimtarisë, anëtar
 - 1.7 Sokol Thaqi- shoqëria civile, anëtar
 - 1.8 Ilir Haxhijaha - zyrtar ligjor, anëtar
 - 1.9 Shpejtim Mustafa - arkitekt, anëtar
2. Grupi punues ka për detyrë që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr.1 Nr. 109, të datës 14.7.2006.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr. 01. Nr. 109, të dates 14.07.2006 dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. Prot. 02/6718, i datës 21.11.2025.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7060 Nr. i faq./Br.str./No.pg 08
Data/Datum/Date 03 / 03 / 2025

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016 nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 6769 të datës 15.12.2025

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi me nr. prot 6769, i datës 15.12.2025 për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive nr. 01 Nr.109, të datës 14 .07.2006.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVES
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M
Për lirimin nga pagesa e taksës komunale

- MIRATOHET** kërkesa e Drejtorisë së Hetimit të Krimeve të Luftës me autorizim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me numër të autorizimit PPS. nr. 02/2026, dhe **LIROHEN** nga pagesa e taksës komunale për sigurimin e **certifikatave të vdekjes në origjinal** për viktimat e vrara më 31.3.1999 në fshatin Pastasellë të Komunës së Rahovecit.
- OBLIGOHET** Drejtorja për Administratë të Përgjithshme që t'i sigurojë certifikatat e vdekjes në origjinal për viktimat e vrara më 31.3.1999 në fshatin Pastasellë të Komunës së Rahovecit, sipas listës së viktimave të bashkëngjitur me kërkesë.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë së Hetimeve për Krimet e Luftës me autorizim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me numër të autorizimit PPS. nr. 02/2026 për sigurimin e certifikatave të vdekjes në origjinal për viktimat e vrara më 31.3.1999 në fshatin Pastasellë të Komunës së Rahovecit, sipas listës së viktimave, konsideron se kërkesa është e bazuar, prandaj, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdest Drejtorja për Administratë të Përgjithshme.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë së Hetimeve për Krimet e luftës,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7064 Nr. i faq./Br.str/No.pg 09
Data/Datumi/Date 04 / 03 / 26
RAHOVEC / OROHOVAČ

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.08/L – 197 , nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e zyrtarëve publikë, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit disiplinor

1. Me këtë vendim **caktohen** anëtarët e komisionit disiplinor të shërbimit civil të administratës komunale të Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Skender Hamza, kryesues,
 - 1.2. Biondina Ramaj, anëtare,
 - 1.3. Agron Thaqi, anëtar.
2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin mbi Shërbimin Civil të Kosovës Nr.08/L-197 dhe nenin 11 të (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e zyrtarëve publikë.
3. Mandati i anëtarëve të komisionit disiplinor është 2-vjeçar, me mundësi vazhdimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit disiplinor.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit disiplinor,
- Udhëheqësit të Personelit, dhe
- Arkivit.

Smaj Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7071 Nr. i faq./Br.str./No.pg 10

Data/Datum/Date 05 / 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit

1. **Caktohet** grupi punues për hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Sylejman Daka, kryesues;
 - 1.2. Biondina Rama, anëtare;
 - 1.3. Ilir Haxhijaha, anëtar.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Strategjinë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRILSDIJA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7072 Nr. i faq/Br.str/No.pg 10

Data/Datum/Date 05 / 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/2023”), nenit 7 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 i Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **AUTORIZOHET** Nazif Durguti, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Farmacist në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, që të punojë jashtë orarit të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës nga data 1.3.2026.
2. I lartpërmenduri në pikën 1 të këtij vendimi ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës 30% në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavës dhe festave zyrtare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe prodhon efekt juridik deri në revokimin e tij.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që barnatorja e cila funksionon në kuadër të QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec punon në të dyja ndërrimet dhe duke marrë parasysh se në këtë institucion punon vetëm një farmacist, i cili është i detyruar që të punojë edhe pas përfundimit të orarit të tij të punës, me qëllim të mbikëqyrjes dhe ofrimit të shërbimeve për pacientët të cilët vizitojnë këtë institucion, Nazif Durguti, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Farmacist në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, është i detyruar që të punojë edhe jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavave dhe festave zyrtare. Për këtë arsye ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës dhe atë 30% në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavave dhe festave zyrtare sipas legjislacionit në fuqi.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Nazif Durguti,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Njësia e Personelit, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**

REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7073 Nr. i faq./Br.str./No.pg 10

Data/Datum/Date 05 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për tërheqjen e *petty cash*-it

1. Egzon Thaqi, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Udhëheqës i Njesisë së Shërbimit të Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET** zyrtar përgjegjës për tërheqjen e *petty cash*-it në Komunën e Rahovecit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për tërheqjen e *petty cash*-it në Komunën e Rahovecit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në aktet e tjera nënligjore në fuqi.
4. Ky vendim prodhon efekt juridik deri në përfundim të vitit fiskal 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Egzon Thaqi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Egzon Thaqi,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIDENTIT TË OPŠTINËS / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7080 Nr. i faq./Br.str./No.pg 10

Data/Datum/Date 10 / 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 7 paragrafi 1 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit, Nr. 1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënien e subvencioneve për ndihma financiare për vitin 2026

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënien e subvencioneve për ndihmat financiare për vitin 2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. Adriatik Avdullahu, kryesues,
 - 1.2. Saranda Rama, anëtare,
 - 1.3. Skender Hamza, anëtar,
 - 1.4. Ekrem Bytyqi, anëtar,
 - 1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie të subvencioneve për ndihma financiare, për banorët rezidentë, për përballimin e shpenzimeve sipas kritereve të parapara në nenin 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit, nr. 1427, të datës 28.4.2017.
3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve, me nr. 1427, të datës 28.4.2017.
4. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për dhënie të subvencioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kritereve për dhënien e subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DShPS-ja, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7084 Nr. i faq./Br.str./No.pg 11

Data/Datum/Date 11 / 03 / 26

RAHOVEC / OPŠINA ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, konkursit kombëtar letrar të shpallur nga të Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me datë 07.11.2025, raportit të Jurisë profesionale, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ekzekutimin e mjeteve financiare

- Me këtë vendim **lejohe**t ekzekutimi i mjeteve financiare për fituesit e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi” si në vijim:
 - 1.1.Vendi i parë – Eljesa Vuçitërna nga Rahoveci, në shumën prej 500€ (pesëqind euro);
 - 1.2.Vendi i dytë – Hazir Luta nga fshati Radoste, Komuna e Rahovecit, në shumën prej 300€ (treqind euro); dhe
 - 1.3.Vendi i tretë – Odise Plaku nga Fieri, Republika e Shqipërisë, në shumën prej 200€ (dyqind euro).
- Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës në Rahovec me vendimin 01 Nr. 1427 të datës 30.04.2019 themeloi çmimin për krijimtari letrare e artistike “Sulejman Krasniqi” për të gjithë ata të cilët kontribuan për kulturën, historinë, ruajtjen e kultivimin e vlerave të traditës në periudha të ndryshme historike.

Bazuar në këtë, është caktuar juria profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare për dhënien e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi”, e cila ka bërë shqyrtimin e të gjitha krijimtarive letrare në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe me datë 07.11.2025 ka hartuar raport me shkrim dhe ka shpallur fituesit e këtij konkursi.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7085 Nr. i faq./Br.str./No.pg 11
Data/Datum/Date 11 / 03 / 26

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe inventari i pa përdorshëm i komunës me Nr. Prot. 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022 dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e veturave jashtë përdorimit

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e veturave jashtë përdorimit në pronësi të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues,
 - 1.2. Samir Hasku, anëtar,
 - 1.3. Luan Sharku, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e veturave jashtë përdorimit në pronësi të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 31.12.2026.
5. Pas përfundimit të punëve, komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**

REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIDENIT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7087 Nr. i faq./Br.str./No.pg 11
Data/Datum/Date 11 / 03 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM
PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

1. **Z. Sefer Sharku** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Mirëqenie Sociale, në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 31.3.2026.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave nga data 31.3.2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Sefer Sharku nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Mirëqenie Sociale, në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 31.3.2026.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e Personelit, ka konstatuar që punëtori i lartpërmendur, më 30.3.2026, arrin moshën e pensionimit (i bën 65 vjet).

Prandaj, Kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit **Sefer Sharku**, nga data 31.3.2026, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.**



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine –



Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ / OPŠTINA ORAHOVAČ / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIRA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7089 Nr. i faq./Br.str./No.pg 11

Data/Datum/Date 11 / 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAČ

Nr.protokollit _____
Me datë, _____
Rahovec

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-40. ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 14 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, neni 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të dates, 29.03.2017, Kryetari i komunës, merr këtë:

V E N D I M

- MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Çifllaku dhe **LEJOHET** pagesa e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën e tij [redacted] në relacionin Çifllak- Ratkoc, për vijimin e mësimit në **SHML "12 Maji"** në Ratkoc, në shumën prej, **40 euro** në muaj, duke filluar prej **1 marsit 2026, deri më, 30 qershor 2026.**
- Mjetet do të sigurohen nga pozicioni i subvencioneve në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Financa dhe Buxhet dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- Me vendim të njoftohen drejtoritë nga pika 3 e këtij vendimi, [redacted] nga Çifllaku dhe arkivi.
- Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij.

U dërgohet:

- Drejtorisë për Financa dhe Buxhet
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- [redacted] nga Çifllaku
- Arkivit



Kryetar i komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESIEDNIKA OPSTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7095 Nr. i faq./Br.str./No.pg 12
Data/Datum/Date 12 / 03 / 26

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 39 dhe 41 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-32, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.16/2017, të datës 23.05.2017, të MASHT-it, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.16/2017, Vlerësimi Pedagogjik i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Ekipit për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore

1. Me këtë vendim, formohet Ekipi Profesional Vlerësues dhe Përkrahës i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmire Kastrati, pedagoge speciale (kryetare e ekipit),
 - 1.2. Blerina Hajda, psikologe shkollore (anëtare),
 - 1.3. Badushe Ukaj, logopede (anëtare),
 - 1.4. Goneta Mustafa, Qendra për Punë Sociale (anëtare),
 - 1.5. Florije Kafegjiu, mjeke sipas nevojës nga QKMF “Dr. Fahredin Hoti”.
2. Prindi apo kujdestari ligjor, gjatë vlerësimit profesional të fëmijës, duhet të jetë prezent ose të konsultohet gjatë gjithë kohës.
3. Detyrat dhe kompetencat e Ekipit Profesional Vlerësues dhe Përkrahës të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, janë të përcaktuara me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2017.
4. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e ekipit, dhe
2. Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7056 Nr. i faq./Br.str./No.pg 12

Data/Datum/Date 12 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Lokal në Komunën e Rahovecit

1. **Caktohet** grupi punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Lokal në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Altin Zhuniqi – drejtor në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, kryesues,
 - 1.2. Afrim Limani - drejtor në Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, koordinator,
 - 1.3. Afrim Dina - drejtor në Drejtorinë për Administratë, anëtar,
 - 1.4. Afrim Oruqi - drejtor në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar,
 - 1.5. Muhamet Morina - drejtor në Drejtorinë për Arsim, anëtar,
 - 1.6. Albnor Mullabazi - drejtor në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar,
 - 1.7. Besmire Bytyqi – drejtoreshë në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtare,
 - 1.8. Përparim Krasniqi - drejtor në Drejtorinë për Shërbime Publike, anëtar,
 - 1.9. Behar Thaqi - drejtor në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar,
 - 1.10. Nora Boshnjaku - drejtoreshë në Drejtorinë për Inspektim, anëtare,
 - 1.11. Atdhe Rama - drejtor në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
 - 1.12. Irfan Berisha – drejtor në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar,
 - 1.13. Artan Asllani – zyrtar në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar,
 - 1.14. Mirsad Shala – zyrtar Ligjor, anëtar,
 - 1.15. Meriton Gashi - zyrtar në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar,
 - 1.16. Saranda Shala - zyrtare në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtare,
 - 1.17. Qemajl Krasniqi – zyrtar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
 - 1.18. Saranda Rama – zyrtare në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare,
 - 1.19. Valon Hoti – zyrtar në Drejtorinë për Inspektim, anëtar,
 - 1.20. Ibrahim Kryeziu – ekspert i jashtëm, anëtar,
 - 1.21. Hashim Rexhepi - ekspert i jashtëm, anëtar,
 - 1.22. Nahit Sharku - ekspert i jashtëm, anëtar,
 - 1.23. Hamëz Rama - ekspert i jashtëm, anëtar,
 - 1.24. Isuf Lushi - ekspert i jashtëm, anëtar,
 - 1.25. Fehmi Hoxha - Ekspert i jashtëm, anëtar.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Strategjinë për Zhvillim Lokal në Komunën e Rahovecit.

3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të grupit punues,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe*
- *Arkivit.*

Smaj Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Orahovec
Opština Orahovac / Municipality Orahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Mayor Office

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7097 Nr. i faq./Br.str./No.pg 12
Data/Datum/Date 12 / 03 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes publike “Përkrahja e fermerëve me pleh artificialë” me nr. prot. 1025, të datës 2.3.2026

1. Caktohet komisioni për vlerësimin aplikacioneve në bazë të thirrjes publike “Përkrahja e fermerëve me pleh artificialë” me nr. prot. 1025, të datës 2.3.2026, në këtë përbërje:
 - a. Veton Mustafa, kryesues,
 - b. Kosovare Gashi, anëtare,
 - c. Dhurata Rrustemi, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes publike “Përkrahja e fermerëve me pleh artificialë” me nr. prot. 1025, të datës 2.3.2026.
3. Obligohet komisioni që këto punët t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të vlerësimit të aplikacioneve, ta njoftojë Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim, Rural, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”) dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për klasifikimin dhe ndarjen e poqeve elektrike dhe të mbajtësve

- Caktohet** komisioni për klasifikimin dhe ndarjen e poqeve elektrike dhe të mbajtësve në ambientet e Komunës, në këtë përbërje:
 - Luan Sharku, kryesues,
 - Petrit Haxhijaha, anëtar,
 - Bekim Bytyqi, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë klasifikimin dhe ndarjen e poqeve elektrike dhe mbajtësve në ambientet e Komunës.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 31.3.2026.
- Pas përfundimit të punëve komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,**
- Drejtoria për Shërbime Publike, dhe**
- Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjestarëve të tyre në republikën e Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-020, nenit 24 të rregullores (QRK) Nr. 01/2018 për Kthimin e Përsonave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, dispozitave të neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për themelimin e komisionit komunal për Kthim në Komunën e Rahovecit

- Me këtë vendim, themelohet komisioni komunal për Kthim në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - Lendrit Qeli, kryesues - ZKKK,
 - Jeton Krasniqi, anëtar - Drejtoria për Arsim,
 - Saranda Rama, anëtare - Drejtoria për Shëndetësi,
 - Besarta Kastrati, anëtare - Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale,
 - Venhar Topalli, anëtar - Drejtoria për Shërbime Publike,
 - Bjondina Ramaj, anëtare - Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor,
 - Kapllan Gashi, anëtar - Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
 - Ivan Saviq, anëtar - përfaqësues i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
- Komisioni Komunal për Kthim është organ rekomandues për rastet si në vijim: Riparimet, ndërtimin, rindërtimin, materialin ndërtimor, pakot ushqimore, artikujt joushqimor, pakot higjienike, orenditë shtëpiake, lëndët djegëse për ngrohje, qiranë dhe alokimin e tokës, me të drejtat e shfrytëzimit për rastet e veçanta sipas Ligjit në fuqi për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
- Te projektet bilaterale, çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqësuesit në komisionin komunal për Kthim nga radhët e donatorit, rregullohet me marrëveshje në mes të MKK-së, Komunës dhe donatorit
- UNHCR-ja ka rolin këshillues në komisionin komunal për Kthim, si dhe është i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllime të monitorimit.
- Komisioni komunal për Kthim mbledhet të paktën 1 (një) herë në muaj, si dhe me kërkesë nga ana e udhëheqësit të ZKKK-së për konsultim me antëtarët e tjerë.
- Komisioni komunal për Kthim është organ rekomandues, i cili propozon rastet pr vendim të komisionit qendror në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
- Mandati i anëtarëve të komisionit komunal për Kthim është 3 (tre)-vjeçar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7103 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 13

Data/Datum/Date 16 / 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 1176, të datës 16.3.2026, për ndërprerjen e kontratës me titull: “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të mospërmbushjes së obligimeve të kontratës, respektivisht mosfurnizimin me artikujt e përshkruar në kontratë.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar kontratë publike kornizë me Grupin e Operatorëve Ekonomikë: Milazim S. Shala; “TOSI – V” Sh.P.K. me seli në Prizren (në vazhdim Kontraktuesi), me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve” me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, me nr. prot. 729, të datës 5.3.2024.

Pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, pas nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi ka hasur në probleme të shumta me ngritjen e çmimit të produkteve që janë pjesë e kësaj kontrate dhe me fuqinë punëtore.

Për këtë arsye, kontraktuesi ka parashtruar kërkesë më datë 13.3.2026, me të cilën ka kërkuar ndërprerjen e kontratës me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, me arsyetimet e paraqitura në kërkesë.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, më 16.3.2026, i është drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim për ndërprerjen e kontratës me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, me nr. prot. 729, të datës 5.3.2024.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me titull “Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”, me nr. të prokurimit 623-24-493-5-2-1/C555, me nr. prot. 729, të datës 5.3.2024, me marrëveshje të dyanshme.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimi të tij, në Autoritetin Kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- *Zyra e Prokurimit,*
- *Menaxheri i projektit,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVO / РЕСПУБЛИКА КОСОВО
KOMUNA E ORAHOVACI / MUNICIPALITY RAHOVEC / ОПШТИНА ОРАХОВАЦ
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINETI I PRESIDNIKU OPSTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7104 Nr. i faq./Br.str./No.pg 13

Data/Datum/Date 16 / 03 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të thirrjes publike për bizneset me Nr.prot.1013 të datës 27.02.2026 dhe nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes “Thirrje publike për aplikim” për të gjitha bizneset që merren me grumbullimin dhe përpunimin e perimeve, me nr. prot. 1013, të datës 27.2.2026, në përbërje prej:
 - 1.1. Kosovare Gashi, kryesuese,
 - 1.2. Veton Mustafa, anëtar,
 - 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e aplikacioneve në bazë të thirrjes “Thirrje publike për aplikim” për të gjitha bizneset që merren me grumbullimin dhe përpunimin e perimeve, me nr. prot. 1013, të datës 27.2.2026.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Bujqësi, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e pronave për caktim të vendit të deponisë vetëm për mbeturina të dheut dhe të betonit dhe në funksion të pajisjes së pëlqimit mjedisor dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përbërje prej:

- 1.1. Biondina Ramaj, kryesuese,
- 1.2. Sylejman Daka, anëtar,
- 1.3. Jetmir Ukaj, anëtar,
- 1.4. Diellza Çanta, anëtare,
- 1.5. Beqir Hamza, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen dhe vlerësimin e këtyre pronave për caktim të vendit të deponisë vetëm për mbeturina të dheut dhe të betonit dhe në funksion të pajisjes së pëlqimit mjedisor dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit.

5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, Thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me nr. Prot. 1046 dhe 1047, të datës 5.3.2026, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të projekteve sipas thirrjes publike në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, me nr. prot. 1046 dhe thirrjes publike për klubet sportive dhe OJQ-të rinore për vitin 2026, me nr. prot. 1047, të datës 5.3.2026

- 1. Caktohet** komisioni për shqyrtimin e ankesave të projekteve sipas thirrjes publike me nr. prot. 1046 dhe thirrjes publike me nr. prot. 1047, të datës 5.3.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Arsim Kastrati, kryesues,
 - 1.2. Granita Behra, anëtare,
 - 1.3. Tefik Krasniqi, anëtar,
 - 1.4. Irfon Ramadani, anëtar rezervë.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e ankesave të projekteve:
 - Në bazë të thirrjes publike për aplikim, me nr. prot. 1046, të datës 5.3.2026, në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për vitin 2026, dhe
 - Në bazë të thirrjes publike për klubet sportive dhe OJQ-të rinore për vitin 2026, sipas thirrjes publike për aplikim, me nr. prot. 1047, të datës 5.3.2026.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Komisioni ka mandat 2 (dy) vjet.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, Thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me nr. prot.1047 të datës 05.03.2026, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në thirrjen publike për klubet sportive dhe OJQ-të rinore për vitin 2026

- 1. Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në bazë të thirrjes publike për klubet sportive dhe OJQ-të rinore për vitin 2026, sipas thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 4047, të datës 5.3.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Qemajl Krasniqi, kryesues,
 - 1.2.** Shqipe Tara, anëtare,
 - 1.3.** Bardhyl Metkamberi, anëtar - ekspert i jashtëm,
 - 1.4.** Luan Danuza, anëtar,
 - 1.5.** Lahuta Dula, anëtare - përfaqësuese e OJQ-së,
 - 1.6.** Senad Alirifa, anëtar rezervë.
- 2.** Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në bazë të thirrjes publike për klubet sportive dhe OJQ-të rinore për vitin 2026, sipas thirrjes publike për aplikim, me nr. prot. 4047, të datës 5.3.2026.
- 3.** Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- 4.** Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- 5.** Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- 6.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- 7.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, Thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me nr. prot.1046 të datës 05.03.2026, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në bazë të thirrjes publike në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për vitin 2026

- Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në bazë të thirrjes publike në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për vitin 2026, sipas thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 4046, të datës 5.3.2026, në këtë përbërje:
 - Muharem Morina, kryesues,
 - Izet Morina, anëtar,
 - Blerta Hasani, anëtare - eksperte e jashtme,
 - Feriz Thaqi, anëtar,
 - Roland Mullaavda, anëtar - përfaqësues i OJQ-së,
 - Shedat Ukaj, anëtar rezervë.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve në bazë të thirrjes publike në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore për vitin 2026, sipas thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 4046, të datës 5.3.2026.
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIEDNIKUT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1121 Nr. i faq./Br.str./No.pg 15
Data/Datumi/Date 23 / 03 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për regjistrimin e veturave që janë jashtë përdorimit në institucionin e Komunës së Rahovecit, në përbërje prej:
 - 1.1. Asllan Mazreku, kryesues,
 - 1.2. Meriton Gashi, anëtar,
 - 1.3. Agnesa Ramadani, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë regjistrimin e të gjitha veturave - automjeteve që janë jashtë përdorimit në institucionin e Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Ekonomi në Komunën e Rahovecit.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Ekonomi, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Servisimi dhe mbushja e aparateve zjarrfikëse”

1. Nijazi Sokoli, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Servisimi dhe mbushja e aparateve zjarrfikëse”.
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



